



Pranuar / Dostiguar Pamflet/Prodato Received/Delivered	01.12	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shlyerja Protog Appetura	Sasia Kuhena Quantity
SKRIPSHIK	7583/2022		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.929/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtare, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.929/2022 të datës 18.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.12.2022 njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.929/2022 e datës 18.10.2022 e parashtruar nga ankuesit
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.Ref.338/2022 i datës 10.10.2022 i Komisionit për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 18.10.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 6287/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.Ref.338/2022 të Komisionit për Grada dhe Disiplinë të Ministrisë së Punëve të Jashtme i datës 10.10.2022, me pretendimet ankimore se është duke iu mohuar e drejta elementare në gradim nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me arsyetimit se gradimi është i qëllimshëm dhe i papazuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 31.10.2022 përmes telefonit ka kërkuar nga Burimet Njerëzore ta përcjellin vetëm vendimin e Komisionit lidhur me refuzimin e kërkesës për gradim, ndërsa kjo e fundit me datë 31.10.2022 ka përcjell shkresën lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6287/2022 të datës 18.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 06.09.2021 të drejtuar zyrës së Sekretarit në MPJD; Akt emërimit të datës 05.09.2012; Kontratën me Nr.ref.MPJ-DA-005/1 të datës 24.11.2010; Vërtetimin me numër të protokollit 214/2014 të datës 18.03.2014; Vendimin me numër të protokollit 07/5569 të datës 24.07.2007; Kontratën mbi vepër me numër të protokollit 071/08 të datës 29.09.2008; Kërkesën për qasje në dokumente me numër 918 të datës 18.03.2022; Vendimin me numër 1114 të datës 30.03.2022; Emilin 30.03.2022 të drejtuar [ ] : Emalin e datës 12.08.2022 të drejtuar [ ] Formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm të datës 27.10.2021; Formularin e vlerësimit për nëpunësin e shërbimit të jashtëm për vitin 2020; Kontratën marrëdhënies së punës të datës 05.09.2012; Certifikatën me shenjen MPJ ID-0036 të datës 29.04.2021; Formularin e vlerësimeve për nëpunësit e shërbimit të jashtëm të vitit 31.10.2016; Diplomën universitare me numër 3858/0321 të datës 16.09.2020; Certifikatën e datës 16.07.2018 lidhur me trajnimin një ditor "Siguria Kibernetike"; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm të datës 16.10.2017; Formularin e vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm të datës 01.11.2018; Vërtetimin me Nr. prot 214/2014 të datës 18.03.2014; Kontratën mbi vepër me Nr.prot071/2008; Kërkesën për grada e datës 06.09.2021 drejtuar Komisionit për grada dhe disiplinë; Vendimin me numër të protokollit 5576/2022 të datës 21.09.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Fletkthesat e datës 21.09.2022; Vendimin me numër 4156 të datës 10.10.2022; Emalin e datës 31.10.2022 të drejtuar [ ] KPMSHC-së; Emilin e datës 10.10.2022 nga [ ] drejtuar [ ] : Vendimin me numër të protokollit 4165 të datës 1.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa A.nr.929/2022 e datës 18.10.2022 është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit me numer AE.Nr.79/2022 të datës 13.06.2022 është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pozitën e punës "Zyrtar për Transport 1" në Departamentin për Shërbime të Përgjithshme, Divizioni për Logjistike dhe Shërbime.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shkresat e administruara të lëndës, ka konstatuar se ankuesi me datë 22.08.2022 kishte parashtruar ankesë në Këshill kundër institucionit punëdhënës, gjegjësisht Komisionit për Grada dhe Disiplinë pasi që të njëjtët nuk e kishin trajtuar, gjegjësisht nuk kishin vendosur me akt administrative lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 06.09.2021 për gradimin e të njëjtit apo avancimin në gradë në kuadër të Shërbimit të Jashtëm Diplomatik, ndërsa Këshilli me datë 21.09.2022 përmes Vendimit A.nr.721/2022 e kishte detyruar Komisionin për Grada dhe Disiplinë që të bëjë shqyrtimin e kërkesës së ankuesit dhe në pajtim me kompetencat që ka, të vendos me akt administrativ duke e pranuar apo refuzuar të njëjtën kërkesë, ndërsa Komisionit për Grada dhe Disiplinë me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit, me datë 10.10.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Ref.338/2022 duke e refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 06.09.2021.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar



se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*", nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, nëpunësit e shërbimit diplomatik kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit diplomatik i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji për kategorinë e nëpunësve civil dhe ligjit të veçantë për shërbimin diplomatik të përcaktuar sipas nenit 4 paragrafi 2, nën paragrafët 2.1; 2.2; 2.3 dhe 2.4 ku caktohet se: "2. Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve".

Me dispozitat e nenit 2 të Ligjit nr. 03/1-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: "Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës"-është komisioni i ngarkuar me dhënien, përveç gradës ambasador, të gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm, si dhe propozimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve të shërbimit të jashtëm dhe shqyrtimin e ankesave për masat disiplinore të marra ndaj tyre", si dhe nenin 14 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin Jashtëm ku përcaktohet se: "1. Komisioni Takohet sipas kërkesës së Kryesuesit që të Konfirmojë dhënien e gradave për anëtarët e rijnë të Shërbimit të karrierës, përfshirë ambasadorët/të ngarkuarit me punë/shefat e misionit, zyrtarët diplomatik dhe konsullor ashtu siç është përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse të ministrisë për angazhim dhe rekrutim; 2. Komisioni takohet me kërkesën e Kryesuesit që të konfirmojë dhënien e gradimeve sipas meritave dhe rritjet e shkallës (gradës) së brendshme që rezultojnë pas shqyrtimit për vlerësimin e rezultateve e të punës siç përcaktohet me këtë rregullore" si dhe nenin 28 paragrafi 1 dhe nenin 30 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 Ligjit nr. 03/1-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: " 28. Avancimi i nëpunësve të shërbimit të jashtëm bëhet duke u mbështetur në sistemin e gradimit. Elementet kryesorë në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës. 30.1 Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës ka për detyrë: 1.1. dhënien e gradave diplomatike dhe konsullore për nëpunësit e shërbimit të jashtëm në përputhje me këtë ligj dhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm" dhe ka ardhur në përfundimin se dhënia e gradave apo ngritja e gradave në Shërbimin Diplomatik është në kompetencë diskrecionale të Komisionit për Grada dhe Disiplinë për Shërbimin e Jashtëm Diplomatik.

Kolegji i Këshilli nga analizimi i bazës ligjore dhe arsyetimit të dhënë si më lartë, thekson faktin se aktet e brendshme normative për Shërbimin e Jashtëm Diplomatik që janë derivat i ligjit të veçantë për shërbimin diplomatik nuk janë të plota, gjegjësisht nuk e kanë përcaktuar specifikisht se në cilat raste Komisioni për Grada dhe Disiplinë duhet apo është i obliguar detyrimisht që t'i aprovojë apo rrisë gradën një nëpunësi të shërbimit diplomatik sipas shprehjes së tij të interesit, gjegjësisht rregullat apo procedurat e përcaktuara nuk janë rregulluar në mënyrë taksative.

Nga si u tha më lartë Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i përcaktuar si në nenin 13 paragrafin 1 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin Jashtëm, funksion si organ kolegjal, andaj Kolegji i Këshillit thekson faktin se në mbështetje të nenit 37 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Organi publik kolegjal (në vijim: organi kolegjal) është një grup personash, të caktuar sipas ligjit, që përfshihen në një procedurë administrative me kompetenca vendimmarrëse apo këshillimore", si dhe nenit 42

paragrafi 2 i të njëjti ligj ku përcaktohet se: "1. Vendimet e organit kolegjial merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Vendimet me procedurë qarkulluese merren me shumicën e votave të anëtarëve të organit kolegjial." rrjedh se Komisioni për Grada dhe Disiplinë i Ministrisë së Punëve të Jashtme vendimin të cilin e ka atakuar ankuesi në këtë ankesë e mbështet në votimin e anëtarëve të komisionit në mbledhjen e datës 09.06.2022 ku me shumicë votash respektivisht me katër vota kundër, asnjë votë pro dhe asnjë abstenim shprehja e interesit të ankuesit kërkesa për gradim e datës 06.09.2021 i është refuzuar me arsyetimin se puna dhe detyrat e \_\_\_\_\_ nuk ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë direkt për marrje të gradës diplomatike.

Si rrjedhojë, pas analizimit të dispozitave ligjore, shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi lidhur me rregullim e shërbimit të jashtëm diplomatik apo dhënies dhe ngritjes së gradave sipas dispozitave të ligjit të veçantë dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej, sikurse edhe mangësisë së përmbajtjes së përcaktuar qartësisht se në cilat raste Komisioni për Grada dhe Disiplinë obligohet detyrimisht që të njoh apo aprovojë dhënien e gradave sipas shprehjes së interesit të zyrtarëve në fjalë, andaj Kolegji i Këshillit thekson faktin se nuk ka diskrecion të përcaktuar ligjërisht lidhur me konstatimet se a i ka takuar apo jo një zyrtari të shërbimit të jashtëm diplomatik dhënia apo ngritja e gradës, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar

Andaj, Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** Lënda me numër A.nr.929/2022

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

*Procesmbajtëse*

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*



#### **Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Komisionit për Grada dhe Disiplinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.